

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA****AC-I-22-0574*****Në ankesën e******Paditësi*****H Sh**, Prizren, të cilin e përfaqëson av. B I, Prishtinë***kundër******E paditura/Ankuesja*****NSH "Ramiz Sadiku" (në likuidim)**, Prizren, të cilën e përfaqëson, **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, Rr. "Dritan Hoxha", nr. 55, Lakërishtë, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe, Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditurës të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-1774 të datës 21 shtator 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 18 tetor 2023, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e të paditurës është e bazuar.**
- 2. Anulohet Aktgjykimi i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, C-IV-14-1774 të datës 21 shtator 2022.**
- 3. Lënda kthehet në shkallën e I-rë të DHPGJS-së për rigjykim.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 18 prill 2014, paditësi përmes postës e dërgoj një ankesë në DHPGJS të paraqitur kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të NSH-së "Ramiz Sadiku", PRZ017-004/0091 të datës 10 mars 2014, me të cilin vendim ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara nga data 01 korrik 1999 e deri me 19 dhjetor 2005, në shumë prej 2.850,00 euro, me arsyetimin se kërkesa është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Në ankesë paditësi e konteston këtë vendim duke pohuar se ai ka punuar në NSH deri në ditën e privatizimit dhe ka të drejtë në paga pasi që ato nuk janë parashkruar. Paditësi me ankesë ka dorëzuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 30 shtator 2015, paditësi e dorëzoi në DHPGJS një parashtresë për plotësim të padisë. Në këtë parashtresë i përsërit pretendimet ankimore dhe kërkon që atij ti paguhen pagat e pa paguara për periudhën e cekur në shumë prej 2.754,00 euro ,interesin ligjor, si dhe shpenzimet e procedurës në shume prej 104 euro.

Me datë 23 maj 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS mbrojtjen në ankesë. Në mbrojtjen në ankesë AKP-ja ka pohuar se Autoriteti i Likuidimit ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. AKP-ja pohon se paditësi ka dështuar të tregoj cili nen i Ligjit të AKP-së është shkelur nga ana e Autoritetit të Likuidimit me vendimin e ankimuar. Tutje AKP-ja pohon se kërkesa për paga për periudhën e cekur është parashkruar pasi që paditësi nuk ka dorëzuar dëshmi për të vërtetuar se ato i ka kërkuar brenda 3 viteve në Gjykatën kompetente.

Me datë 15 korrik 2022, paditësi e dorëzoi një parashtresë si përgjigje ndaj urdhrorit dhe përgjigjet në mbrojtjen e AKP-së. Në këtë parashtresë prape i përsërit të njëjtat pretendime që i kishte dhënë në ankesë. Bashkë me këtë parashtresë paditësi e ka dorëzuar njoftimin e AKM-së për ndërprerje të marrëdhënies se

punës me datë 20 shkurt 2006, kopjen e Librezës së punës e mbyllur me 21 shkurt 2006, listat e pagave të pa paguara lëshuar nga NSH-ja.

Me datë 02 gusht 2022, AKP-ja e dorëzoi në DHPGJS kundërpërgjigjen në të cilën prape AKP-ja mban qëndrimin se kërkesa për paga për periudhën e cekur është parashkruar. Në këtë parashtresë AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pa bazuar.

Me datë 21 shtator 2022, Shkalla e I-rë e DHPGJS me Aktgjykimin C-IV-14-1774 e aprovon ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ndryshon vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit duke detyruar të paditurën të paguaj paditësit në emër të pagave të pa paguara për periudhën 1 korrik 1999 e deri me 19 dhjetor 2005 shumen prej 2.754,00 euro ,si dhe interesin ligjor prej 10%. Në pikën 2 të dispozitivit është e obliguar e paditura të paguaj edhe shpenzimet e procedurës në shume prej 229,00 euro ,sipas prioritete të përcaktuara me ligj në procedurën e likuidimit .

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së ka arsyetuar se pala e paditur nuk i ka kontestuar provat e sjellura nga paditësi, si njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, listën e pagave, librezën e punës, e po ashtu nuk e ka kontestuar as lartësinë e kërkesës në emër të pagave të pa paguara. E paditura e ka kontestuar vetëm për shkak të parashkrimit të kërkesës duke konsideruar se kërkesa për paga është parashkruar në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar. Tutje Shkalla e I-rë ka konstatuar se në bazë të nenit 387 par.1 të LMD-së ,parashkrimi ndërpritet kur debitori e pohon borxhin ndërsa në bazë të nenit 392 par.1 të LMD-së pasi ndërprerjes së parashkrimit fillon të rrjedh përsëri afati i ri i parashkrimit. Në këtë rast NSH-ja e paditur duke lëshuar njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës me 21 shkurt 2006 ka pohuar ekzistimin e borxhit ndaj paditësit dhe me këtë është ndërprerë rrjedha e parashkrimit të kërkesës. Prandaj duke u bazuar në këto dispozita ligjore dhe në praktiken e jurisprudencës së Kolegjit të Apelit AC-I-21-0577 ,dhe AC-I-21-0580, është aprovuar kërkesë-padia e paditësit si e bazuar .

Me datë 19 tetor 2022, AKP-ja e dërgoj në DHPGJS një ankesë kundër Aktgjyqimit të Shkallës së I-rë të DHPGJS, C-IV-14-1774, të datës 21 shtator 2022, për të gjitha bazat ankimore dhe kërkon nga Kolegji i Apelit të aprovohet ankesa si e bazuar, të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim, ose të refuzohet padia si e bazuar. Për më tepër në ankesë AKP-ja ka pohuar se Aktgjykimi i ankimuar nuk i përmbush kriteret e nenit 54 të LDHP-së pasi që në Aktgjykim nuk janë prezantuar gjetjet faktike që kane rëndësi materiale për rastin. Tutje AKP-ja pohon se Autoriteti i Likuidimit e ka refuzuar kërkesën për paga pasi që ankuesi nuk ishte punëtor aktiv në momentin kur ka filluar procedura e Likudimit ndaj NSH-së. AKP-ja konsideron se njoftimi për ndërprerje të marrëdhënies së punës në të cilën thirret paditësi nuk është aspak provë që vërteton se atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Ky njoftim është një shabllon i cili iu dërgohet të gjitha punëtorëve dhe nuk mund të interpretohet si pranim i borxhit.

Me datë 12 dhjetor 2022, paditësi e dorëzon në DHPGJS një parashtresë dhe i përgjigjet në ankesën e AKP-se. Në këtë parashtresë paditësi e kundërshton ankesën AKP-së si të pabazuar dhe kërkon që të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së si i bazuar në ligj. Tutje paditësi ka pohuar se në ankesë ka sqaruar mjaftueshëm lidhur me argumentet e ngritura të ankesës dhe përsëritja e atyre argumenteve do të ishte e pa dobishme për mbarëvajtjen e procedurës. Paditësi pohon se nuk qëndrojnë pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe as pretendimet për shkelje të dispozitave materiale dhe procedurale. Në këtë parashtresë paditësi në mbështetë të pretendimet të tij u referohet disa rasteve nga jurisprudenca e Kolegjit të Apelit. AKP-ja ka kërkuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e AKP-së është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i Shkallës së I-rë të DHPGJS-së, nuk është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjorë, andaj duhet të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi me datë 01 gusht 2006 e ka dorëzuar një kërkesë tek Autoriteti i Likuidimit duke i kërkuar pagat e pa paguara nga NSH NIN "Ramiz Sadiku" në Prizren (në likuidim), për periudhën korrik 1999 e deri 19 dhjetor 2005, në shumë prej 2.850,00 euro. Kjo kërkesë është refuzuar si e pa vlefshme nga ana e Autoritetit të Likuidimit me arsyetimin se ajo është parashkruar, në bazë të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar.

Shkalla e I-rë e DHPGJS-së me Aktgjykimin e ankimuar e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe ka ndryshuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit, duke e obliguar të paditurën të paguaj borxhin në emër të pagave të pa paguara në shume prej 2.754,00 euro dhe interesin ligjor prej 10%. Shkalla e I-rë ka konstatuar se paditësi ka sjell njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies se punës, kopjen e librezës se punës dhe listat e pagave të pa paguara, që janë prova të mjaftueshme për ta aprovuar ankesën.

Kolegji i Apelit nuk e mbështet konstatimin e Autoritetit të Likuidimit se kërkesa për këto paga për tërë periudhën e cekur është parashkruar.

Paditësi ka sjell Njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës me datë 21 shkurt 2006, që vërteton se ai ka punuar në NSH deri në ditën e privatizimit të NSH-së. Paditësi po ashtu ka sjell kopjen e Librezës së punës që është mbyllur me 21 shkurt 2006, do të thotë në ditën e privatizimit të NSH-së, si dhe një kopje të Listës së pagave të pa paguara nga ana e NSH-së.

Duke marrë parasysh faktin se paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me datë 21 shkurt 2006, atëherë dele që në bazë të këtij njoftimi të AKM-së, pagat nga muaji shkurt 2003 e deri në dhjetor 2005, nuk janë parashkruar, ndërsa pagat nga muaji korrik 1999 e deri në janar 2003, janë parashkruar. Është i gabuar Aktgjykimi i shkallës së I-rë, dhe pa mbështetje ligjore, kur me këtë Aktgjykim, paditësit ja njeh të drejtën në paga për tërë periudhën kohore, në shumë prej 2,754.00 euro dhe interesin ligjor prej 229,00 euro.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi e ka ofruar një listë të pagave të mbetura borxh nga ana e NSH-së për tërë periudhën kohore, për të cilën ai i kërkon pagat prej NSH-së, duke kalkuluar shumën prej 2,754.00 euro. Në këtë listë të pagave nuk ka të dhëna për pagën mujore të paditësit. Duke qenë se mungon prova lidhur me pagën mujore të paditësit për periudhën kohore për të cilën kërkesa nuk është parashkruar, përkatësisht për periudhën shkurt 2003 e deri në dhjetor 2005, Kolegji i Apelit nuk ka mund të vendosi në merita lidhur me kërkesën për paga për këtë periudhë kohore. Andaj nga këto arsye Kolegji i Apelit konstaton se lënda duhet të kthehet në shkallën e I-rë për rigjykim, në mënyrë që paditësit dhe AKP-së ti jepet rasti të sjellin prova konkrete se cila ishte lartësia e pagës mujore e paditësit në NSH për këtë periudhë kohore.

Andaj pas vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, shkalla e I-rë e DHPGJS-së duhet të vendos në merita të ankesës të paraqitur ndaj vendimit të ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv.

Taksat gjyqësore

Ankuesja tashmë e pa paguar taksën gjyqësore për procedure ankimuar ne shume prej 100 euro me date 10 nëntor 2022, andaj nuk do te caktohen taksa shtese.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 18 tetor 2023.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar kryesues
